

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Ekonomise Publike
dhe Privatizimit

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Mesme e te Vogla



URDHER
Nr 324 Date 7.9 1999

PER
PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA CMIM FILLESTAR TE PAKETES SE
AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE ANONIME
"PRODHIM MATERIAL NDERTIMI "ELBASAN

Ne baze nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, me cilesine e aksionerit te vetem , ne mbeshtetje te Ligjit Nr 8334 date 23.4.1998 " Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik , V.K.M. Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik, VKM Nr. 684 date 28.18.1998 "Per nje shtese dhe ndryshim ne VKM Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare, qe veprojne ne sektoret jo strategjike, VKM Nr 405 date 31.8.1999 "Per procedurat e privatizimit me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik, VKM Nr 407 date 31.8.1999 "Per privatizimin me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare"

Urdheroj:

1-Te privatizohet me ankand, pa cmim fillestar paketa shteterore e aksioneve te "Prodhim Material Ndertimi " Sh.A Elbasan , sipas V.K.M. nr 405 date 31.8.1999 , dhe V.K.M.nr 407 date 31.8.1999.

2-Transferimi i paketes shteterore te aksioneve ne masen 51 %, percaktuar sipas V.K.M. Nr. 684 date 28.10.1998.

3-Dokumentacioni i depozituar ne Agjensine Kombetare te Privatizimit me shkresat nr 5081 date 5.10.1998 sipas V.K.M nr 446 date 9.7.1998 te sherbeje per fillimin e procedurave te privatizimit.

4-Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi

5- Urdheri nr. 36 date 29.7.1999 anullohet.

MINISTRI

Ylli BUFI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr 3018 Rep 22.12.99
VËRTETIM
Z. D. F. me Nr Pasaporte
Paraqiti Dekumentin Origj Unë Vërtetoj
që Fotkopja Është një me Originalin

Notere
AFERDITA HAXHIZ
TIRANE





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE *Byrthe*
NOTER *Artemisa Meçaj*
Nr. *884*...Regj.Nr. *321*...Kod



Nr. 3455 Prot.

Tirane, 18.11. 1999

KONTRATE

PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE PREJ 51% (PESEDHJETE E NJE PERQIND) TE "PRODHIM MATERIAL NDERTIMI "SH.A. ELBASAN

Sot, me date 18.11.1999 (njemije e nenteqind e nentedhjte e nente), ditën e premte, ne Agjensine Kombetare te Privatizimit Tirane, perpara meje noteres se Dhomes se Noterise Tirane, Z. Artemisa MEÇAJ, hartohet kontrata e shitjes se paketes se aksioneve prej 51% e barabarte me 82.620 aksione ne "Prodhim material ndertimi " SH.A.Elbasan, ,te regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.17691 Akt., date 10.09.1997,

midis paleve te cilat rane dakord si me poshte :


Neni 1 - Palet

1.1 *Pala shitese*: Agjensia Kombetare e Privatizimit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjthshem i saj, Z. Qirjako Theodhori.

1.2 *Pala blerese*: "2K Group" Sh.p.k. i njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.19653 Prot., date 22.06.1998, perfaqesuar nga Z Koço Kokedhima i biri i Theodhoriut dhe i Efijeni i lindur ne Qeparo Vlore me 21.04.1959 me numer pasaporte 0183354 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me adrese banimi : Rruga "5 Maji" Tirane. i shpallur fitues ne ankandit e zhvilluar date 20 Tetor 1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit, i njohur me autorizimin leshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit me Nr.3004, date 20.10.1999, per kryerjen e pagese se vlefte se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 51 % te "Prodhim material ndertimi " SH.A.Elbasan.

Neni 2 - Objekti i kontrates

Objekt i kesaj kontrate eshte shitja (transferimi) e 51% te aksioneve e barabarte me 82.620 (tetedhjte e dy mije e gjashteqind e njet) aksione te zoteruara nga Shteti Shqiptar, perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise Publike e Privatizimit, ne "Prodhim material ndertimi " SH.A.Elbasan, me vlere 11.111.111 leke (njembedhjte milion e njetqind e njembedhjte mije e njetqind e njembedhjte).



Kapitali themeltar i shoqerise ne momentin e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendimin Nr.17691 date 10.09.1997, te pasqyruar edhe ne Akt themelimin dhe Statutin e shoqerise rezulton me vlere 162.000.000 leke (njqind e gjashtedhjetë e dy milion) me 162.000 aksione me vlere nominale te nje aksioni 1000 leke, kapital sipas vleresimit me dokumentin bilanci reformuar i bazuar mbi bilancin ushtrimor te vitit 1996 i specifikuar : a) shuma e ndertesave me vlere 110.004.412 leke dhe b) vlere e truallit sipërfaqe 127.808 m² sipas genplaneve dhe akt-vleresimeve qe shoqerojne keto genplane me vlere 20449280 leke.

Neni 3 - Çmimi i shitjes

- 3.1. Çmimi i shitjes se paketes se aksioneve prej 51% e barabarte me 82.620 aksione te zoteruar nga shteti ne shoqerine "Prodhim material ndertimi " SH.A.Elbasan eshte 11.111.111 leke (njembedhjetë milion e njeqind e njembedhjetë mijë e njeqind e njembedhjetë), vlere e realizuar ne ankandin e dates 20.10.1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit dhe paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve, Dega Tirane, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjensise Kombetare te Privatizimit.
- 3.2. Pala shitesë deklaron se ne favor te saj eshte derdhur e gjithë shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate sipas mandat arketimit leshuar nga Banka e Kursimeve me numer 295128 date 11.11. 1999 per shumen 11109111 leke (njembedhjetë milion njeqind e nente mijë e njeqind e njembedhjetë) dhe mandat arketimi numer 0918167 date 12.11.1999 i Bankes Kursimeve Tirane per shumen 2000 (dymijë) leke . Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 11.111.111 leke (njembedhjetë milion e njeqind e njembedhjetë mijë e njeqind e njembedhjetë).

Neni 4 - Kushtet e shitjes

- 4.1. Pala blerese gjykohet se ka njohuri te plota per paketen e 51 % te aksioneve qe i eshte ofruar per blerje , me oferten e dhene nga ajo.
- 4.2. Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitesë ne autorizimin Nr.3004 prot, date 20.10.1999(njemije e neneteqind e netedhjetë e nente) te Agjensise Kombetare te Privatizimit Tirane.
- 4.3. Pala blerese pas nenshkrimit te kesaj kontrate, noterimit te saj behet pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me regjistrimin e kesaj pakete aksionesh prej 51 % e barabarte me 82.620 aksione qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.
- 4.4. Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e prej 51 % e aksioneve e barabarte me 82.620 aksione te "Prodhim material ndertimi " SH.A.Elbasan transferohet nga Ministria e Ekonomise Publike e Privatizimit tek "2K Group" Sh.p.k. perfaqesuar nga Z.Koço Kokedhima, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit

- 5.1. Bleresi ka pranuar blerjen e paketes shtetereore prej 51 % te aksioneve te "Prodhim material ndertimi" SH.A.Elbasan sipas proces-verbalit te zhvillimit te ankandit dhe akt marreveshjes se nenshkruar per kushtet e privatizimit te paketes se aksioneve date 20.10.1999 zhvilluar ne Agjencine Kombetare te Privatizimit.
- 5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi paketen prej 51 % te aksioneve te blera prej tij pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.
- 5.3. Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.
- 5.4. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per regjistrimin e pasurive te paluajtshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme te Rrethit Elbasan.

Neni 6 -Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.

- 6.1. Pala shitese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi paketen prej 51 % te aksioneve te SH.A. "Prodhim material ndertimi" Elbasan, te ofruara per blerje pales blerese.
- 6.2. Pala shitese garanton bleresin per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi kete objekt kontrate perballe organeve gjyqesore ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo kerkohet

Neni 7 -Baza ligjore per lidhjen e kontrates

1. Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
3. Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
4. Ligji Nr. 8334, date 23.04.1998
5. VKM.Nr.446, date 09.07.1998,
6. VKM Nr. 405, date 31.08.1999;
7. VKM Nr. 407, date 31.08.1999;
8. Udhezimi Nr. 3, date 01.10.1999;
9. Aktmarrveshja nenshkruar midis paleve ditën e zhvillimit te ankandit date 20.10.1999.
10. Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit Nr. 324, date 07.09.1999.

Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengiiten kesaj kontrate



NOTER
TIRANE

Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit, Nr. 324, date 07.09.1999, per privatizimin e paketes prej 51% te SH.A "Prodhim material ndertimi " Elbasan me dy flete fotokopje e noteruar.

8.2. Autorizimi Nr.3004 Prot., date 20.10.1999, per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes se aksioneve prej 51 % te SH.A., "Prodhim material ndertimi " Elbasan leshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit.

8.3. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit me Nr.7145 Prot., 08.11.1999 me kater flete fotokopje e noteruar.

8.4. Akt-marreveshje date 20.10.1999 nenshkruar midis paleve ne kete kontrate ditën e zhvillimit te ankandit, me nje flete fotokopje e noteruar.

8.5. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.7145/1 Prot., date 11.11.1999 me nje flete fotokopje e noteruar.

Neni 9 - Te ndryshme

9.1. Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me nga 4 faqe prej te cilave nje kopje qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjencise Kombetare te Privatizimit dhe dy kopje i jepen pales blerese.

9.2. Pala shitesë pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noterja . ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.



PALET KONTRATUESE

PALA SHITESE

QIRJAKO THEODHORI

DIREKTOR I PERGJITHSHME

që Fotokopia është një me Originale,

VERIFITIM

POSAPORTE

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi

Origjinali Dekumentit Origjinali Unë Vertetoi



NOTER

NOTERE

EMISA MECAJ

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE

NOTERE


PALA BLERESE

"2K GROUP" Sh.P.K.

PERFAQESUAR NGA

Z.KOÇO KOKEDHIMA

Handwritten signature of Z. Koço Kokedhima





REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr.1254/76 Regjistri Themeltar
Nr.141 Vendimit

V E N D I M

" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e Shkalles se Pare Tirane e perbere prej:

KRYESUES : ZEGJINE SOLLAKU
ANETAR : PAJTIM HOXHA
ANETAR : FLUTURA SKENDERI

Asistuar nga *sekretare: Suela Pashaj*, sot me date 02.02.2006, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me detyr te hapura ceshtjen civile qe iu perket paleve:

PADITES: **Thanasa Gega**, i biri i Llambit dhe i Sines, d.dl.1929, banues ne Elbasan, perfaqesuar ne gjykim nga av. Artur Gumbardhi.
Sokrat Gega, i biri i Llambit dhe i Sines, d.dl.1932, banues ne Tirane, perfaqesuar ne gjykim nga av. Artur Gumbardhi.
Dafina Gega, e bija e Llambit dhe Sines, d.dl.1936, banuese ne Elbasan, perfaqesuar ne gjykim nga av. Artur Gumbardhi.

I PADITUR: **Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a** Elbasan, perfaqesuar ne gjykim nga av. Gentian Mete.
Ministria e Ekonomise, perfaqesuar ne gjykim nga avokat Shtetit Zhuljien Ristani.

OBJEKTI: Detyrimi i te paditurve te njohe pronarin e truallit, si ortak te shoqerise per vleren e truallit ne shumen 20 449 280 leke.

1

Shperblimin e demit duke me paguar fitimin e munguar.

BAZA LIGJORE: *Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", si dhe neni 640 i K.Civil.*

Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin nr.6335 date 21.12.2004 ka vendosur:

- Pranimin e kerkese padise.
- Detyrimin e anes se paditur "PMN" sh.a te njoh ortak paditesit Thanasa Gega, Sokrat Gega, Dafina Gega.
- Detyrimin e anes se paditur Ministria e Ekonomise te njoh paditesit Thanasa Gega, Sokrat Gega, Dafina Gega ortak me 12.623.012% te aksioneve ne shoqerine "PMN".
- Detyrimin e te paditurit "PMN" te shperbleje paditesit demin e shkakuar ne masen 98.862 leke.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen anes se paditur.

Kunder ketij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a Elbasan e cila parashton keto shkaqe per prishjen e vendimit dhe rrezimin e padise si te pa bazuar ne ligj dhe prova:

Vendimi nuk eshte i mbeshtetur ne ligj dhe ne prova. Per sa ka vendosur ne kete vendim gjykata eshte investuar tej asaj qe vete kjo pale ka kerkuar ne kerkese-padi. Gjykata eshte treguar e njehshme ne menyren e zbatimit te procedures se gjykimit.

I gjithi pretendimi i paditesave per tu njohur si aksionere te Shoqerise anonime dhe per shperblimin e demit (fitimit te munguar) mbeshetet ne moszbatimin e urdhrerit Nr.115 date 01.03.2001 te M.E.P.P. Ky urdher eshte absolutisht i pavlefshem pasi eshte nje akt administrativ i leshtuar ne kundershimi me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji. Nga Ministri jane tejkaluar kopetencat ligjore.

Ne statusin e shoqerise percautohet se aksionet e Shoqerise nuk jane lirishit te transfereshme tek te tretet. Ata i nenshtrohen miratimit paraprak te asamblese se aksionereve.

Se pari: Akti administrativ i leshtuar nga nje institucion publik qe urdheron nje person juridik privat me te cilin ka lidhur mardhenie bashkeproniese mbi kapitalin e Shoqerise tregtare, nuk gjene mbeshetje ligjore.

Se dyte: Urdherit nr.115 date 01.03.2001 te M.E.P.P i mungon objekti.

2



GJYKATA E APELIT TIRANE

Si degjoj relatinin e ceshtjes nga gjyqtare Z.Sollaku, palen ankuese te paditurin Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a Elbasan perfaqesuar nga av.Gentian Mete i cili kerkoi ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e kerkese-padise paditesit perfaqesuar nga av.Artur Gumbardhi i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, te paditurin Ministria e Ekonomise perfaqesuar nga av.Shtetit Zhuljien Ristani i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, si e shqyrtoi dhe e bisedoi ceshtjen ne teresi:

V E R E N

Se vendimi Nr.6335 date 21.12.2004 i Gjykates se Shkalles se pare Tirane eshte ne zbatim te drejte te ligjit procedural dhe atij material ndaj si i tille vendimi duhet te lihet ne fuqi.

Nga hetimi gjyqesore i zhvilluar nga Gjykata e Shkalles se pare ka rezultuar e porvuar se:

Paditesi Thanasa Gega, Sokrat Gega e Dafina Gega jane trashegimtare ligjore te radhes se pare te trashegimlensit Llambi Gega dhe se vendimin nr.151 date 08.05.1998 te K.K.K.Pronave Elbasan trashegimlensit i paditesave eshte njohur pronar mbi truallin ne te cilin eshte ngritur Shoqeria "PMN" sh.a, duke iu njohur e drejte e parblerjes dhe e privatizimit sipas ligjeve ne funksion te privatizimit te ekonomise.

Me pretendimin se si pronare te truallit kane te drejte ne baze te ligjit qe te marrin aksione ne vleren e truallit te njohur nga vendimi i K.K.K.Pronave, ne Shoqerine "PMN" sh.a dhe te hynje ne kete shoqeri pa marre pjese ne ankand, paditesat i jane drejtuar gjykates me kerkese-padine ne objekt "Detyrimin e te paditurve te njohin paditesit aksionere te Shoqerise me objekt "Detyrimin e te paditurve te njohin paditesit aksionere te Shoqerise me 12.6230123% ne vleren 20.449.280 leke si dhe detyrimin e Shoqerise "PMN" sh.a ti shperbleje demin e shkakuar sipas aktit te ekspertimit, kerkese-padi e cila sipas vendimit nr.6335 date 21.12.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare eshte pranuar.

3



Ndaj ketij vendimi ka paraqitur ankim i paditurin Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a i cili pretendon se gjykata eshte treguar e njehshme ne zbatimin e procedures se gjykimit dhe se ky vendim dhe pretendimi i paditesave mbeshetet ne moszbatimin prej tij te urdhrerit nr.115 date 01.03.2001 te Ministrise te Ekonomise Publike dhe Privatizimit nje urdher ky absolutisht i pavlefshem.

Kolegji Civil i Gjykates e Apelit Tirane referuar teresise se provave te ndodhura ne dosje dhe shkaqeve te ngritura ne ankim nga i paditur cmon se ceshtja eshte zgjidhur drejte nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane dhe se shkaqet e ngritura ne ankim nuk jane te bazuara duke mos pasqelle ndryshimine vendimit Nr.6335 date 21.12.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare objekt ankimi.

Keshitu nga aktet ne dosje sikurse arsyetohet dhe ne vendim rezulton se Shoqeria "PMN" sh.a eshte regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin Nr.17961 date 10.09.1997. Fillimisht aksioner i vetem i kesaj shoqerie ka qene shteti perfaqesuar nga Ministria e Privatizimit (sot Ministria e Ekonomise) me kapital 162.000.000 leke, nga ku vlera e truallit eshte 20.449.280 leke. Me pas me urdherin Nr.324 date 07.09.1999 te Ministrise te Ekonomise dhe Privatizimit eshte urdheruar "Privatizimi ne ankand i paketes shtetore te aksioneve te Shoqerise "PMN" sh.a Elbasan sipas V.K.M nr.405 date 31.08.1999 dhe V.K.M nr.407 date 31.08.1999". Transferimi i paketes se aksioneve ne masen 51% percaktuar sipas VKM nr.684 date 28.10.1998.

Pas urdhrerit te mesiperm shoqeria "PMN" rezulton me aksionere Shoqerine "2K.Grup" sh.p.k me 51% te aksioneve dhe Ministria Publike me 49% te aksionereve. Duke patur shumicen e aksioneve ne Shoqerine "PMN" sh.a, Shoqeria "2K Grup" ne daten 29.12.1999 ka depozituar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne zyrën e Regjistrimit Tregetar Mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshtme te Aksionereve te dates 24.11.1999 ku midis te tjerave ka vendosur ndryshime ne statut. Ne nenin 8 te statutit eshte parashikuar se: "Aksioneret e Shoqerise jane persona fizik dhe juridik qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksionet e Shoqerise ne te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji...". Po keshitu eshte riformuluar dhe neni 10 i statutit duke percaktuar se: "Aksionet e Shoqerise nuk jane lirishit te transfereshme tek te tretet". Ato i nenshtrohen miratimit paraprak te asamblese se zakonshtme. Ato u shiten te tretete kur ato refuzohen te blihen nga aksioneret e tjere te Shoqerise".

Gjithashtu rezulton se Ministria e Ekonomise Publike dhe e Privatizimit me urdherin Nr.115 date 01.03.2001 me cilesine e zoteruesit te 49% te aksioneve te Shoqerise "PMN" sh.a dhe sipas te drejtes qe i jep statuti

4



i Shoqerise, depozituar ne momentin e regjistrimit te Shoqerise si person juridik dhe konkretisht neni 4 i tij sipas te cilit "Aksionet e Shoqerise mund tu shiten personave fizik dhe juridik veten ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Privatizimit", ka urdheruar te transferohet paketa e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise anonime "PMN" sh.a ne masen 12.6230123 % te kapitalit te regjistruar ne Gjykate me vleren 20.449.280 leke.

Ndonesse ka dale urdheri i mesiperm i Ministrise te Ekonomise Publike dhe Privatizimit i paditurin Shoqeria "PMN" sh.a nuk ka pranuar te njoh paditesit si ortak te Shoqerise per vleren e truallit ne shumen si mesiper prej 20.449.280 leke, me pretendimin se aksionet e Shoqerise nuk jane lirishit te transfereshme tek te tretet, ata i nenshtrohen miratimit paraprak te asamblese se zakonshtme te aksionereve dhe se urdheri i Ministrise te Ekonomise Nr.115 date 01.03.2001 eshte marre ne kalim te kopetencave, pa marre pelqimin e ortakut "2K Grup" sh.p.k e per rrjedhoje nuk mund te kete fuqi detyruese ndaj Shoqerise "PMN" sh.a.

Ne lidhje me sa pretendon i paditur rezulton e pa bazuar per aresye se: Urdheri i Ministrise te Ekonomise dhe Privatizimit Nr.115 date 01.03.2001 eshte nxjerre ne zbatim te ligjit nr.8334 date 23.04.1998 si dhe VKM nr.119 date 18.03.2000. Sipas ligjit Nr.8334 date 23.04.1998 "Per Privatizimin e Shoqerive Tregtare" qe veprojne ne sektoret ky strategik ne nenin 1 percaktohet se: "Paketa e aksioneve per ish pronarin e truallit eshte pjese e aksioneve me te cilat ish pronari i truallit hyn ne Shoqerine Tregtare pa pjesmarjen ne ankand". Ndresa sipas nenit 6 te po ketij ligji per zbatimin e ketij ligji ngarkohet Ministria e Ekonomise dhe Privatizimit. Po keshitu urdheri nr.115 date 01.03.2001 i Ministrise te Ekonomise dhe Privatizimit eshte ne perputhje dhe me nenin 8 te ndryshuar te statutit te Shoqerise te cituar me lart.

Ndodhur ne kushtet e nje rregullimi ligjor sic percakton ligji Nr.8334 date 23.04.1998, sikurse arsyetohet dhe Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, nuk ka vend per miratim paraprak te asamblese apo dispozitive te vendosura ne statut sic pretendon e paditura Shoqeria "PMN" sh.a.

I paditurin Ministria e Ekonomise perfaqesuar nga avokatura e shtetit ne kerkimin e tij ishte per lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare objekt ankimi, si vendim i marre ne perputhje me ligjin dhe provat e administruara ne dosje.

Per sa me lart ky kolegj cmon se ceshtja eshte zgjidhur drejte nga gjykata dhe nuk jane lejuar shkaqe si ne aspektin procedural ashtu dhe ne ate material.

5

PER KETO ARESYE

Gjykata e Apelit Tirane ne baze te nenit 466/a te K.Pr.Civile

V E N D O S I

Lenien ne fuqi te vendimit Nr.6335 date 21.12.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

*U shpall ne Tirane
Sot me dt.02.02.2006*


ANETAR
F.SKENDERI
d.v

ANETAR
P.HOXHA
d.v

ANETAR
Z.SOLLAKU
d.v

vertetohet njesia me origjinalin
KANCELARE

Dak.S.Pashaj



6

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E LARTE
KOLEGJI CIVIL

Nr.11118-01474-00-2006 i Rregj. Themeltar
Nr.00-2007-1319 i Vendimit (1303)

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Kolegji Civil i Gjykates se Larte i perbere nga:

Artan Hoxha
Nikoleta Kita
Perikli Zaharia
Shpresa Beçaj
Ardian Nuni

Kryesues
Anetar
Anetar
Anetar

Sot me date 16.11.2007, mori ne shqyrtim ne dhome keshillimi ceshtjen civile qe i perket:

PADITES: **THANASA GEGA**
SOKRAT GEGA
DAFINA GEGA

E PADITUR: **SHOQERIA "PRODHIM MATERIAL NDERTIMI" SH.A.**
MINISTRIA E EKONOMISE

OBJEKTI I PADISE: *Detyrimin e te paditurve te njohe pronarin e truallit si ortak te shoqerise per truallin ne shumen prej 20 449 280 leke. Shperblimin e demit, duke me paguar fitimin e munguar.*

1



BAZA LIGJORE:

Ligji nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe neni 640 te K.Civil.

Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane, me vendimin Nr.6335, date 21.12.2004 ka vendosur:

- Pranimin e kerkese padise.
- Detyrimin e anes se paditur "PMN" sh.a. te njoh ortak paditesit Thanasa Gega, Sokrat Gega, Dafina Gega.
- Detyrimin e anes se paditur Ministria e Ekonomise te njoh paditesit Thanasa Gega, Sokrat Gega, Dafina Gega ortak me 12 623 012% te aksioneve ne shoqerine "PMN".
- Detyrimin e te paditurit "PMN" te shperbleje paditesit demin e shkakuar ne masen 98.862 leke.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin Nr.141, date 02.02.2006 ka vendosur:

- Lenien ne fuqi te vendimit Nr.6335, date 21.12.2004 te gjykates se shkalles se pare Tirane.

Kunder vendimit te mesiperm ka ushtruar rekurs pala e paditur Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a, e cila kerkon rrezimin e padise si te pambeshtetur ne ligj e ne prova.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATES SE LARTE

Pasi degjoj relacionin perkates dhe diskutoi ceshtjen ne teresi,

V E R E N

Rekursi i paraqitur nga pala e paditur Shoqeria "Prodhim Material Ndertimi" sh.a, nuk permban shkaqe nga ato qe parashikon neni 472 i K.Pr.Civile per kalimin e ceshtjes per gjykim.

PER KETO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykates se Larte, mbeshetur ne nenin 480 te K.Pr.Civile,

2

ANETAR
Perikli ZAHARIA

ANETAR
Nikoleta KITA

KRYESUES
Artan HOXHA

ANETAR
Ardian NUNI

ANETAR
Shpresa BEÇAJ

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 3512 REP.
NR. 1746 KOL.



**KONTRATE SHIT-BLERJE
(AKSIONE)**

Në Tiranë, sot me datë 24/8/2011, përpara meje Noteres [Signature], me adresë në Rr. V. Koda Tiranë, u paraqiten palët e nëposhtme kontraktuese dhe kërkuar redaktimin e kësaj kontrate shit-blekje të aksioneve:

Shitësi : Shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k, e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 19653 vendimi datë 22.06.1998 dhe NIPT J82221005L, përfaqësuar nga nga Ortaku i Vëllim Kozo Kolëdhima, i biri i Theodhoriut, lindur në 21/04/1959 në Qeparo, Vloë dhe banues në Tiranë Rr. "Ismail Qemali", Pallati "ABISSNET", shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër 028976599, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, referuar në poshtë si «**Shitësi**».

Blerësi : Shoqëria "DOMUS SILVA-ALBANIA" Sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 08/11/2010 dhe NIPT, L02308032J përfaqësuar nga Ortaku i Vëllim Besa Kolëdhima, e bija e Kozos, lindur në 29/05/1986 në Fier dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër 030122822, madhore dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, referuar në poshtë si «**Blerësi**».

Përkufizime

- Shitësi dhe Blerësi bashkërisht do të referohen si "Palët".

Kushte të përgjithshme

A. Shoqëria « Prodhim Materiale Ndërtimi » sh.a., është një person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar në bazë të vendimit me Nr. datë 10.09.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kapitali i shoqërisë "Prodhim Materiale



Ndërtimi" sh.a.. përbëhet nga 109.600 (njëqind e nëntë mijë e gjashtëqind) aksione, me vlerë nominale 1.000. Lek secila që bëjnë në total vlerën e kapitalit 109.600.000 (njëqind e nëntë milion lekë e gjashtëqind mijë) Lekë.

B. Shoqëria "DOMUS SILVA-ALBANIA" Sh.p.k, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 08/11/2010 me kapital 10.000 (një mijë) Lekë, dhe NIPT L02308032J, me objekt Shitjen me shumice dhe pakice të punimeve prej druri, importin dhe eksportin e lëndës drusore bruto. Si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të ligjshëm në fushën e drurit apo aktiviteti tjetër të mundshëm në përputhje me ligjet në fuqi.

C. Shitësi zotëron 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione me vlerë nominale 1.000 Lek secila, që i përkasin 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të aksioneve në kapitalin e shoqërisë "Prodhim Materiale Ndërtimi" sh.a..

D. Duke qenë se aksionet e shoqërisë "Prodhim Materiale Ndërtimi" Sh.a janë lirish të transferueshme.

Atëherë palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti

1.1. Objekti i kësaj kontrate është shitja e 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve që Shitësi zotëron në kapital me vlerë nominale 1,000 Leke secila. Këto aksiona transferohen nga Shitësi në pronësi të Blerësit.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe Mënyra e Pagesës

2.1 Aksionet shiten kundrejt çmimit total prej 2,000,000 (dy milion) Lekë.

2.2 Çmimi i shitjes do t'i likujdohet Shitësit nga Blerësi jashtë zyrës noteriale, në njërën prej formave të njohura nga ligji, nëpërmjet bankës apo arkës.



Neni 3

Kalimi i pronësisë mbi aksionet

3.1. Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota i 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve në kapitalin e shoqërisë "Prodhim Materiale Ndërtimi" sh.a. menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dy palët dhe Shitësi heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim, të drejta apo detyrime lidhur me këto aksione.

Neni 4

Garancitë

4.1 Shitësi është pronari i vetëm i ligjshëm i 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve në kapitalin e shoqërisë "Prodhim Materiale Ndërtimi" Sh.a.

4.2 Shitësi garanton Blerësin që 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksionet e transferuara janë krejtësisht të lira nga çdo peng dhe barrë.

Neni 5

Regjistrimi

5.1 Shitësi dhe Blerësi pranojnë t'i japin njëri tjetrit me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të transferuar pjesët e kapitalit që janë objekt i kësaj kontrate dhe për ta regjistruar këtë transferim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në bazë të nenit 119 pika 5 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » dhe nenit 43 pika 4 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

6.1 Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe çdo interpretim në lidhje me sa është shprehur më sipër, apo çdo paqartësi përsa i përket interpretimit do të bëhet në përputhje të plotë me këto ligje.

6.2 Për çdo që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë, gjejnë zbatim dispozitat ligjore të parashikuara në pikën 6.1.

Neni 7
Juridiksioni

7.1 Në rast të mosmarrëveshjeve që nuk zgjidhen me mirëkuptim mes Palëve, juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 8
Të ndryshme

8.1 Kushtet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.

8.2 Kjo kontratë është përfundimtare midis palëve dhe konkludon vullnetin e shprehur në të gjitha marrëveshjet e mëparshme midis tyre, me shkrim apo me gojë.

8.3 Çdo ndryshim apo amendim në lidhje me kushtet e mësipërme dhe pranuar nga Palët apo çdo shtim i ndonjë kushti tjetër lidhur me qëllimin e kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

Kjo kontratë u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, nga një për t'u mbajtur nga Palët, një e mban noterja dhe një për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët, para meje, dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.


Shitësi
Shoqëria
"2K GROUP" Sh.p.k

Ortaku i Vetëm
Koço KOKËDHIMA



Blerësi
Shoqëria
"Domus Silva- Albania" Sh.p.k

Ortaku i Vetëm
Besa KOKËDHIMA



DOMUS SILVA -
ALBANIA
NIPT: 02308032

VENDIM NR. 3

I

ORTAKUT TË VETËM

Dt. 20.08.2011

Në Tiranë, sot më dt. 20.08.2011, unë Besa KOKËDHIMA, me cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë "DOMUS SILVA-ALBANIA" Sh.p.k., shoqëri e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 08/11/2010 dhe NIPT L02308032J, me seli në Tiranë ne adresën Rr: "Ismail Qemali", Pallati Abissnet, Kati 11,


VENDOSA

1. *Te blejë 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione, që përbëjnë totalin e aksioneve të zotëruara nga shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k në kapitalin e shoqërisë "Prodhim Material Ndërtimi" Sh.a dhe të ofruara për shitje nga shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k.*
2. *Nëpërmjet shitjes së 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve nga shoqëria "2K Group" sh.p.k. tek shoqëria "Domus Silva- Albania" Sh.p.k, shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k humbet të drejtën e zotërimit dhe çdo të drejtë tjetër lidhur me 55.896 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksionet e zotëruara në shoqërinë "Prodhim Materiale Ndërtimi" sh.a.*
3. *Kontrata e shitblerjes së aksioneve do të nënshkruhet nga unë, Besa Kokëdhima në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "Domus Silva-Albania" shpk*

Për Shoqërinë "DOMUS SILVA-ALBANIA" sh.p.k.

ORTAKU I VETËM

Besa KOKËDHIMA



DOMUS SILVA -
ALBANIA
NIPT: L02308032

VENDIM NR. 4

I
ORTAKUT TË VETËM

Dt. 20 . 08 .2011

Në Tiranë, sot më dt. 20 . 08 .2011, unë KOÇO KOKËDHIMA, me cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë "2 K Group" sh.p.k., shoqëri e regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 19 653, dt. 22/06/1998 me seli në Tiranë ne adresën Rr: "Ismail Qemali", Pallati Abissnet, Kati 2,

VENDOSA

1. Te shesë 55.896,00 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione, që përbëjnë totalin e aksioneve të zotëruara nga shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k në kapitalin e shoqërisë "Prodhim Material Ndërtimi" Sh.a dhe të ofruara për shitje nga shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k.
2. Nëpërmjet shitjes së 55.896,00 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve nga shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k. tek shoqëria "DOMUS SILVA-ALBANIA" Sh.p.k, shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k humbet të drejtën e zotërimit dhe çdo të drejtë tjetër lidhur me 55.896,00 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksionet e zotëruara në shoqërinë "Prodhim Materiale Ndertimi" Sh.a.
3. Kontrata e shit-blerjes së aksioneve do të nënshkruhet nga unë, Koço KOKËDHIMA, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "2K Group" shpk.

Për Shoqërinë "2 K Group" sh.p.k.

ORTAKU I VETËM

KOÇO KOKËDHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE Durrës
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
NOTERE Majlinda S. Lato
Nr. 404 Rep.
Nr. 168 /3 Kol.



DËSHMI TRASHËGIMIE TESTAMENTARE

Sot më datë 14 Shkurt 2015 (dymije e pesëmbëdhjetë) une Notere Majlinda S. Lato, Anëtare e Dhomës së Noterëve Durrës, me seli ne adresen: Lagjia “5 Maj”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga:

KËRKUESI: z.**Petrit Gega** me atesi Sokrat, amesi Kristina, datelindja 30.07.1961, lindur ne Katund i Ri, Elbasan dhe banues ne Katund i ri 165, Komuna Bradashesh, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr.030928729, me nr.personal G10730102H te leshuar date 12.04.2011.

OBJEKTI: Lëshimi i dëshmisë së trashëgimise testamentare per trashegimlensesen **Kristina Nos Gega** (nena e kërkuessit).

BAZA LIGJORE: -Neni 316 , 318, 348 , 372 e vijues të Kodit Civil te vitit 1994(i ndryshuar);

- Ligji nr. 7829 date 01.06.1994 “Per Noterine”, i ndryshuar.
- Ligji 121 dt.18.04.2013:”Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 7850, date 29.07.1994 “Kodi Civil I RSH”” te ndryshuar.
- Ligji 131 dt. 29.04.2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7829 dt.01.06.1994” Per Noterine”” te ndryshuar.

Une Noterja, pasi studiova provat shkresore dhe mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Petrit Gega.

VEREJ:

Se nga kerkuesi Petrit Gega eshte depozituar ne zyren noteriale nje kerkese me ane te se cilës kerkohet "Leshimi i dëshmise se trashëgimisë testamentare per trashëgimlensesen, te ndjeren Kristina Nos Gega".

Nga dokumentat e depozituara si Proçes Verbal mbi kalimin e akteve te vullnetit te fundit ne repertorin e akteve midis te gjalleve date 14.02.2015, çertifikata e vdekjes, certifikata familjare, certifikate personale si dhe nga shpjegimet e kerkuesit ne kerkese rezulton se :

Trashëgimlensesia Kristina Gega, me atësi Nos, amësi Sina, datelindja 09.08.1936, lindur ne Fikas, Elbasan ka vdekur ne Katund i Ri, Elbasan me date 21.02.2012. Trashëgimlensesia Kristina Gega rezulton te kete lene testament. Keshtu me date 04.10.2011 nga une noteria Majlinda S. Lato eshte redaktuar testamenti me nr.1014 akteve te vullnetit te fundit date 04.10.2011 ne te cilin trashëgimlensesia Kristina Gega ka shfaqur vullnetin e saj si me poshte :

"Kerkoj qe te sistemoj qe me gjalljen time pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme pas vdekjes time. Me vullnet te lire deklaroj se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Sokrat Gega, datelindja 30.07.1961, i cili me respekton dhe kujdeset per mua per gjithçka qe une kam nevojë duke perjashtuar çdo trashëgimtar tjeter ligjor. E theksoj dhe njehere se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Gega duke perjashtuar çdo trashëgimtar tjeter ligjor qe ka te beje me kete trashëgimi. Ky eshte vullneti im i fundit dhe kerkoj qe te respektohet nga te gjithë qe kane te bejne me kete trashëgimi".

Rezulton se me date 14.02.2015 nga une noteria Majlinda Lato eshte mbajtur Proces Verballi mbi kalimin e akteve te vullnetit te fundit ne repertorin e akteve midis te gjalleve me nr.403 rep dhe Nr.167 kol. me kerkues Petrit Sokrat Gega.

Nuk rezulton te kete ndonje testament tjeter qe te mbaje ndonje date te mevonshme apo ndonje deklarate e bere nga testatoria trashëgimlensesë , e cila te lëre pa fuqi kete testament.

Per sa konstatova me siper nga ana ime notere Majlinda Lato, anetare e Dhomes se Noterise Durres, me seli ne Elbasan konkludohet se:

Meqenese trashëgimlensesia Kristina Gega ka lene testament do te zbatohet rregulli i trashëgimise testamentare ne leshimin e deshmise se trashëgimise pasi prej meje nuk konstatohet ndonje rast pavlefshmerie nga ato te parashikuara ne nenet 403-409 K.Civil, te ndryshuar.

Si trashëgimtar testamentar do te thirret kerkuesi z.Petrit Sokrat Gega, datelindja 30.07.1961, lindur ne Katund i Ri, Elbasan dhe banues ne Katund i Ri 165, Komuna Bradashesh, madhor, shtetas shqiptar, i cili do te trashëgoje pasurine e percaktuar ne testamentin me nr.1014 akteve te vullnetit te fundit date 04.10.2011 te

depozituar ne zyren e noteres Majlinda Lato, pasi ky eshte vullneti i trashegimlenses dhe kerkuesi Petrit Gega rezulton te kete zotesi per te fituar me testament.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenet 316, 317, 318,320,348, 360,372,374,392,397,403-409 te K.Civil te vitit 1994 te ndryshuar dhe bazuar ne Ligjin nr.131 dt.29.04.2013 "per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7829 dt. 01.06.1994 "Per Noterine" te ndryshuar

VENDOSA:

-Leshimin e deshmise se trashegimise testamentare per trashegimlensesen **Kristina Nos Gega.**

-Njohjen si trashegimtar testamentar te trashegimlenseses Kristina Nos Gega, **ë.Petrit Gega** me atësi Sokrat, amësi Kristina, datelindja 30.07.1961, lindur ne Katund i Ri, Elbasan dhe banues ne Katund i Ri 165, Komuna Bradashesh, me nr personal G10730102H , i martuar, madhor, me shtetesi shqiptare, *mbi të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme që ka dhe atë që mund ti vijë në të ardhmen trashegimlenseses, sipas disponimeve ne testamentin me nr. 1014 akteve te vullnetit te fundit date 04.10.2011.*

-Akti i Deshmise se Trashegimise testamentare duhet te rregjistrohet ne Zyren e Rregjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rast te disponimit te pasurive te paluajtshme nga trashegimlensesia brenda nje afati 30 ditor nga data e leshimit te ketij akti sipas nenit 38 dhe 39 te ligjit 33/2012 "Per rregjistrimin e pasurive te Paluajtshme".Pas ketij afati aplikohet kamate vonese per çdo dite vonese.

- U leshua në Elbasan, sot më datë 14 Shkurt 2015.

NOTERE
MAJLINDA S. LATO





PROÇES VERBAL

Mbi kalimin e akteve te vullnetit te fundit ne repertorin e akteve midis te gjalleve.

Sot me date 14.02.2015 (katermbedhjetë shkurt dymijë e pesëmbedhjetë) ne zyrën e time te ndodhur ne lagjen "5 Maj", pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga unë noteria Majlinda S. Lato redaktohet ky akt me kërkesën e z.**Petrit Gega** i biri i Sokrat-it dhe Kristina, datelindja 30.07.1961, lindur ne Katund i Ri, Elbasan dhe banues ne Katund i ri 165, Komuna Bradashesh, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me nr.030928729, me nr.personal G10730102H te leshuar date 12.04.2011.

I sipërpërmenduri pasi më paraqiti çertifikatën e vdekjes me nr.006180319 të lëshuar nga zyra e gjendjes civile Bradashesh datë 05.02.2015 sipas së cilës rezulton se e ndjera **Kristina Gega**, me atesi Nos, amesi Sina, datëlindja 09.08.1936, lindur ne Fikas, Elbasan, ka vdekur ne shtëpi ne Katund i Ri, Elbasan më datë 21.02.2012, më kërkoi kalimin e testamentit të lënë nga testatoria nga akti i vullnetit të fundit në repertorin e akteve midis te gjalleve. Per kete aresye nxorra nga fashikulli i testamenteve testamentin me nr.1014 akteve te vullnetit te fundit date 04.10.2011 te depozituar ne arkiven e kesaj zyre dhe pasi e lexova me rezultoi si vijon :-----

"Kerkoj qe te sistemoj qe me gjalljen time pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme pas vdekjes time. Me vullnet te lire deklaroj se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Sokrat Gega, datelindja 30.07.1961, i cili me respekton dhe kujdeset per mua per gjithçka qe une kam nevojë duke perjashtuar çdo trashëgimtar tjetër ligjor. E theksoj dhe njehere se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Gega duke perjashtuar çdo trashëgimtar tjetër ligjor qe ka te beje me kete trashëgimi. Ky eshte vullneti im i fundit dhe kerkoj qe te respektohet nga te gjithë qe kane te bejne me kete trashëgimi".-----

Pas kesaj bera kalimin e ketij akti te vullnetit te fundit ne repertorin e akteve midis te gjalleve duke bere shenimet perkatese ne baze te ligjit "Per noterine".-----

Çertifikata e vdekjes dhe testamenti i bashkengjiten ketij akti qe perben nje te vetem.----

Mbi sa me siper ky akt u redaktua ne tre kopje te njejta origjinale nje fleteshe me nje faqe te shkruar, iu lexua kerkuesit, u nenshkrua prej tij dhe ne fund u vertetua nga une noteria sipas ligjit. Kopja e pare origjinale u depozitua prane kesaj zyre dhe dy kopje te tjera iu dhane kerkuesit.

KERKUESI

Petrit Gega

NOTERE

MAJLINDA S. LATO

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE DURRES
ZYRA NOTERIALE ELBASAN

Nr. 1014 akteve te
vullnetit te fundit.



TESTAMENT

Ne Elbasan sot me date 04.10.2011 (kater tetor dymije e njembedhjete), para meje noteres Majlinda S. Lato me zyre timen te ndodhur ne lagjen "5 Maj", prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan u paraqit personalisht shtetasia shqiptare: zj. **Kristina Gega** e bija e Nos dhe Sina, lindur me 09.08.1936 ne Fikas, Elbasan dhe banuese ne Katund i Ri, Elbasan, Komuna Bradashesh, madhore dhe e afte per te kryer veprime juridike, e njohur nga une noteria ne baze te leternjoftimit qe me paraqiti me numer 031376090, me nr.personal D65809043O te leshuar nga Ministria e Brendshme date 13.09.2011, e cila me kerkoi redaktimin e ketij testamenti ne pranine e te thirrurve prej saj: z. **Jakov Çullhaj** i biri Dhimiter, lindur me 28.11.1964 ne 29 Nëntori, Elbasan dhe banues ne Elbasan, me nr.leternjoftimi 025437054, me nr.personal G41128161E te leshuar date 10.05.2009 dhe te z. **Hysni Dërvishaj** i biri Serjan, datelindja 23.10.1961, lindur e banues ne Katund i Ri, Elbasan, mbajtes i leternjoftimit me nr.025759077, me nr.personal G11023005D te leshuar date 23.05.2009, te cilet me deklaroi njohjen me testatoren dhe me garantuan per identitetin e saj: -----

Nga biseda paraprake qe zhvillova me testatoren dhe ne baze te raportit mjeko ligjor me nr.regjistri 2557 date 03.10.2011 konstatova se ajo eshte ne gjendje te mire mendore dhe e afte per te kryer kete veprim juridik dhe per kete i kerkova qe te deklaronte vullnetin e saj dhe ajo me deklaroi si vijon: -----

"Kerkoj qe te sistemoj qe me gjalljen time pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme pas vdekjes time. Me vullnet te lire deklaroj se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Sokrat Gega, datelindja 30.07.1961, i cili me respekton dhe kujdeset per mua per gjithçka qe une kam nevojë duke perjashtuar çdo trashegimtar tjeter ligjor. E theksoj dhe njehere se te gjithë pasurine time te luajtshme dhe te paluajtshme qe kam dhe ate qe mund te me vije ne te ardhmen pas vdekjes time e testatoj ne favor te djalit tim Petrit Gega duke perjashtuar çdo trashegimtar tjeter ligjor qe ka te beje me kete trashegimi. Ky eshte vullneti im i fundit dhe kerkoj qe te respektohet nga te gjithë qe kane te bejne me kete trashegimi".-----

U pyet testatoria nese ka gje tjeter per te shtuar dhe ajo deklaroi se nuk ka gje tjeter per te shtuar.-----

Ky akt filloi te redaktohet ne oren 9.⁰⁰ dhe perfundoi ne oren 9.³⁰ te dates 04.10.2011.-----

Mr. Dervishaj
[Signature]



Jakov Çullhaj
[Signature]

0372 Ky akt hartohet ne baze te kerkesave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, neni e vijues i ketij kodi.

Mbi sa me sipër u redaktua ky akt ne tre kopje te njejta origjinale dy fleteshe me nga nje faqe te shkruar secila, iu lexua testatores me ze te larte ne pranine e te thirrurve prej saj z.Jakov Çullhaj dhe z.Hysni Dërvishaj. Testatorja me deklaroi se e degjoi dhe e kuptoi ne menyre te qarte testamentin. Gjithashtu testatorja me deklaroi se nuk mund te shkruaje dhe ngarkoi per te nenshkruar ne emer te saj z.Jakov Çullhaj, i cili nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne emer te testatores. Gjithashtu kete testament e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire edhe z.Hysni Dërvishaj, i pranishem ne kete akt dhe i thirrur nga testatorja. Ne fund u vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit dhe konform tij. Dy kopje origjinale te ketij testamenti u depozituan prane kesaj zyre dhe nje kopje tjeter origjinale iu dha testatores.

TESTATORIA

Kristina Gega

Ngarkon per te nenshkruar
ne emer te saj z.Jakov Çullhaj

Jakov Çullhaj
Kristina Gega



Ne prani te :

z. Hysni Dërvishaj

Hysni Dërvishaj
Kristina Gega

NOTERE

MAJLINDA S. LATO

Majlinda S. Lato
J. Delli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË-TIRANË
NR. 723+REP.
NR. _____ KOL.

3013

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pallatit
U Paga



KONTRATË SHIT-BLERJE
(AKSIONE)

Në Tiranë, sot, më datë 26 / 11 / 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Noteres Majlinda E. Demollari, me seli ne adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Vaso Pasha", Pallati nr.10, Shk. nr.1, Ap. nr.3, Tiranë, u paraqitën personalisht palët si më poshtë:

